



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.179 dt.18.12.1998

**NDRYSHIM I DESTINACIONEVE TE TRE PROJEKTEVE KULTURORE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Kulturës, lidhur me kërkesën për ndryshim destinacioni të tri projekteve kulturore, në bazë të ligjit Nr.7572, neni.45, pika.16

**VENDOSI**

**1. Projekti kulturor Nr.27.**

Ditët e Kulturës Tiranase në Itali, që do të realizohet në bashkëpunim me shoqatën “CULTURA DEI MARI” të bëhet në Shqipëri në muajin Dhjetor 98 midis shoqatave, asaj Shqiptare dhe asaj Italiane.

**2. Projekti kulturor Nr.24.**

Turneu i Orkestrës Frymore të Bashkisë i planifikuar në Zvicër, të kthehet në Itali, mbështetur nga ftesa e palës pritëse.

**3. Projekti kulturor Nr.30.**

Të ndryshojë trupa artistike emrin, në vend të Cirkut të Tiranës, të shënohet “Të rinjtë e Bashkisë së Tiranës”.

4. Ngarkohen për realizimin e këtyre ndryshimeve Drejtoria e Kulturës dhe Financës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**